



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 43, datë 28.09.2021

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETIT TË KËSHILLIT BASHKIAK  
SKRAPAR PËR VITIN 2022”.**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 28.09.2021, pasi mori në shqyrtim projektaktin e paraqitur nga Kryesia e Këshillit Bashkiak Skrapar, hartuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, duke pasur si qëllim kryesor përmbushjen me sukses të detyrave që burojnë nga ky ligj dhe në zbatim të rregulloreve për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Skrapar, Marrëdhënjet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median, Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarit bashkiak, Shqyrtimi dhe miratimi i peticioneve dhe iniciativave qytetare, Strukturat komunitare dhe ndërveprimet e tyre me Këshillin Bashkiak

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit të Aktivitetit të Këshillit Bashkiak Skrapar për vitin 2022, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Këshilli Bashkiak Skrapar
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 11 vota pro , vota kundër - s'ka , 1 votë abstenim.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK**  
**Edlira SHKËMBI**

Plani i Aktivitetit të Këshillit Bashkiak Skrapar për vitin 2022

Pershkrimi i aktivitetit

Periudha

Pershkrimi i aktivitetit	Periudha											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Mbledhje Keshilli - 12												
1 në çdo muaj, të cilat thirren bazuar në neni 53												
Funksionimi i këshillit bashkiak, pika 2. Mbledhjet e radhës												
së këshillit bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit												
që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj +												
mbledhje jashtë radhe thirrur në zbatim të neni 53, pika 3.												
Këshilli mbledhet në çdo rast: a) me kërkesën e kryetarit të												
bashkisë;b) me kërkesën me shkrim të jo më pak se 1/3 së												
anëtarëve të tij;c) me kërkesën e motivuar të prefektit për												
çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.												
Mbledhje Komisionit të Përhershëm (mesatarisht 4-5												
mbledhje komisionesh në muaj)												
Takime me komunitetin, konsultimet kerkuar nga ligji:												
buxhet, ndryshim buxheti, pakete fiskale- per çdo NjA dhe												
me biznesin,												
shitje, blerje e dhenje me qera, norma e standarte te												
sherbimeve publike dhe funksioneve te tjera ligjore.												



(Buxheti- cdo Nj/A+ komuniteti biznesit+OJF;  
P fiskale- cdo Nj/A+ komuniteti biznesit+OJF;  
ndryshim buxheti - 1 konsultim ne qytet dhe 1 konsultim ne  
zonen gjeografike qe afektohet nga ndryshimi.

**Takime me komunitetin, konsultimet jo të kerkuar nga**

**ligji:**

plani strategjik,

plani social

Plani urban

Plani për rrugët, etj (sipas parashikimeve per vitin 2022)

Initiativa qytetare (ligji 139/2015, neni 20) dhe në zbatim të

rregullores së Këshillit Bashkiak për: Shqyrtimin dhe

miratimin e Peticioneve dhe Iniciativave Qytetare.

Takimi i vjetor i keshillit me qytetaret per prezantimin e raportit te veprimtarise vjetore (llogaridhenja)

Pjesëmarrje e këshilltarëve ne konferenca e aktivitetete të ngjashme

Trajnime te Këshilltarëve me fonde të këshillit (dy në vit )

Trajnime te Këshilltarëve me fonde jo të këshillit (dy në vit )

Trajnime te Sekretariatit me fonde të këshillit (dy në vit )

Trajnime te Sekretariatit me fonde jo të këshillit (dy në vit )

Vizite studimore ne Shqiperi me fonde të këshillit (dy në vit )

Vizite studimore ne Shqiperi me fonde jo të këshillit (dy në vit )

Vizite studimore jashte vendi



Ceremoni për dhënie titulli nderi																					
Takime me veteranet dhe pjesëmarrje në festa e ngajtje vendore dhe kombetare																					
Prijje delegacioni nga keshilla homologe																					
Hartimi, miratimi i buxheti vjetori të KB për vitin 2022 dhe përcjellja për implementim të dokumentit final të buxhetit të bashkisë																					
Plotësimi i regjistrimit të Ankesave, Kërkesave dhe Vërçitjeve (ligji nr. 139/2015, neni 19, ligji nr. 146/2014, neni 21)																					
Ndërtimi i regjistrimit të Kërkesave për informim për dokumentacionin e keshillit (ligji 119/2014)																					
Plotësimi i regjistrimit elektronik të paketeve të shqyrtuara nga Këshilli																					
Plotësimi i regjistrimit elektronik të Vendimmarrjes nga Këshilli																					
Plotësimi i regjistrimit elektronik të Vendimmarrjes nga Këshilli të pakonfirmuara nga institucioni i prefektit																					
Hartim i Planit dy vjeçar për trajnimin e Këshilltarëve																					
Aktivitetet me nxenesit me rezultate shumë të mira në mesime si dhe perkrahja e talentëve të reja në fusha të ndryshme me rastin e festave të fund viti																					
Hartim i Dokumentit të politikës për shpenzimet e Keshillit dhe përdorimin e mjediseve dhe shërbimeve publike nga Keshilltarët																					
Anketimi vjetor për vlerësimin nga komuniteti të punës dhe rezultateve të Keshillit																					

**KRYETAR E KESHILLIT BASHKIAK**

**Edlira SHKËMBI**

